

**Akt themelimi dhe Statut.**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“PLAY BAR” SHPK**

**Kapitulli I**

**FORMA, EMËRTESA, OBJEKTI KOHËZGJATJA DHE SELIA**

Sot më datë 02/11/2023, personi i mëposhtëm:

1. Arta Sakolli, i datelindjes 18/04/1975, lindur ne Berat, Shqiperi,dhe banuese ne adresen: Rruga 30 Vjetori, Berat.Shqiperi,mbajtesi i leternjoftimit me Nr.H55418066H.

ka vendosur të nënshkruajnë këtë Akt Themelimi dhe Statut për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “PLAY BAR” shpk – në vijim referuar si “Shoqëria”.

**Art. 1 – Forma e shoqërisë**

- 1.1. Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas parashikimeve të këtij akt themelimi dhe statuti.
- 1.2. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj sipas ligjit shqiptar në fuqi.

**Art. 2 – Emërtimi**

2.1 Shoqëria ka emërtesën “PLAY BAR” shpk.

**Art. 3 – Objekti i aktivitetit.**

- 3.1 Shoqëria ka si objekt aktiviteti:
  - Bar Kafe.
  - Cdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 3.2 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të hyjë në direkt ose indirekt në shoqëri të tjera, të cilat mund të kenë objekt tjetër aktiviteti, në përputhje me ligjin.
- 3.3 Shoqëria mund të kryejë aktivitet tregtar për realizimin e qëllimeve të saj, dhe mund të zhvillojë cdo aktivitet për shitblerje të pasurive të paluajtshme; aktivitete tregtare; financiare; qiradhënie; të depozitojë garanci dhe depozita; dhe cdo aktivitet tjetër që e konsideron të arsyeshme në objektivat e saj.
- 3.4 Shoqëria do të realizojë direkt ose indirekt, cdo aktivitet tregtar të lejuar nga ligji, që është i lidhur me objektin e saj të aktivitetit, apo për realizimin e qëllimeve.

#### **Art. 4 – Selia.**

- 4.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Njesia Administrative Kashar, fshati Yzberisht.Rruga Tre Deshmoret.Zona kadastrale 3866, Nr Pasurie 369/42.Volumi 129 fq 204, Indeksi Hartes K34-100. Tirane.
- 4.2 Asambleja e përgjithshme mund të ndryshojë selinë e shoqërisë, në një vend tjetër; të hapë filiale dhe degë; në Shqipëri ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Art. 5 – Kohëzgjatja.**

- 5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të shpërndahet para kohe sipas ligjit nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.

#### **Art. 6 – Përgjegjësia.**

- 6.1 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për detyrime të marra përsipër nga ortakët në emrin e tyre personal jashtë shoqërisë.

### **Kapitulli II** **Kapitali i shoqërisë**

#### **Art. 7 – Kapitali**

- 7.1 Kapitali i shoqërisë është 100 000 (një qindmije) lek.

#### **Art. 8 – Shlyerja dhe zotërimi i kuotës.**

- 8.1 Kapilai është si vijon:

1. Arta Sakolli, ka paguar vlerën 100 000 lek.

- 8.2 Kapitali zotërohet si vijon:

Arta Sakolli, zoteron 1 kuotë te kapitalit që përbën 100 përqind.

#### **Art. 9 – Zmadhimi i kapitalit**

- 9.1 Asambleja e shoqërisë mund të zmadhojë kapitalin e shoqërisë.

9.2 Administratori i shoqërisë do të paraqesë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit dhe mund ta batojë edhe në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë.

9.3 Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv nga data e rregjistrimit dhe publikimit në QKR.

#### **Art. 10 – Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë.**

10.1 Pas miratimit të bilancit vjetor të mëparshëm, asambleja e përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit me fitimin që nuk është ndarë, dhe duke respektuar rezervat ligjore.

10.2 Rezervat që shkon mbi 1/10 e kapitalit të rregjistruar, dhe fitimet e pandara mund të transferohen për kapital themeltar.

10.3 Rezervat dhe fitimi i pandarë nuk mund të përdoren për zmadhim kapitali nëse bilanci i vitit parardhës nuk rezulton me humbje.

#### **Art. 11 – Zvogëlimi i kapitalit**

11.1 Asambleja e përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin, por jo nën minimumin e parashikuar nga ligji.

11.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortakët në përqindjen që ata kanë në shoqëri.

11.3 Vendimi i asamblesë së përgjithshme për zvogëlimin e kapitalit njoftohet në qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë.

#### **Art. 12 – Transferimi i kuotës**

12.1 Transferimi i kuotave tek persona të tretë jashtë shoqërisë bëhet vetëm me vendim paraprak të asamblesë së shoqërisë.

12.2 Transferimi i kuotës për cdo arsy i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga ortakët e tjerë; që e ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve që nga data që marrin njoftim me postë rekomande, letër e cila përimban edhe ofertën. Nëse ortakët nuk përgjigjen brenda afatit 30 ditor ata nënkuptohet se kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes.

12.3 Ortakët që e kanë shfrytëzuar të drejtën e parablerjes, kanë të drejtë që me të njëjtin procedurë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për ortakun që nuk e ka ushtruar këtë të drejtë.

12.4 Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga më shumë se një ortak, atëherë pjesa e kuotës që kalohet në pronësi ndahet në përpjestim me përqindjen në kapital të sëcilit ortak që ushtron të drejtën e parablerjes.

12.5 Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga një ortak ai blen kuotën ose një pjesë të saj.

12.6 Ortakët njoftojnë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

12.7 Të gjitha njoftimet për procedurat e mësipërme, njoftohen nëpërmjet administratorit të shoqërisë.

### **Kapitulli III**

#### **Asambleja e Përgjithsme, administrimi, kontrolli.**

## **Art. 14 – Të drejta dhe detyrime:**

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për të marrë këto vendime::

- a) përcaktimi i politikave të shoqërisë;
- b) ndryshimi i statutit;
- c) emërimi dhe lirimi i administratorit;
- c) shkarkimi i administratorit;
- d) emërimi dhe revokimi i likujdatorëve dhe ekspertëve;
- e) përfimet ekonomike të administratorëve dhe likujdatorëve;
- dh) monitorimi i punës së administratorëve për realizimin e politikave ekonomike dhe hartimit të bilanceve të shoqërisë;
- g) miratimi i bilancit të shoqërisë dhe ecuria e shoqërisë;
- f) zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
- g) ndarja dhe anullimi i kuotave;
- h) përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë kundër administratorëve; I
- k) riorganizimi ose shpërndarja e shoqërisë;
- h) miratimi i rregullave proceduriale të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme;
- i) të marrë vendime për cështje të tjera të parashikuara nga ligji.

## **Articolo 15 – Mbledhja e asamblesë së përgjithshme.**

15.1 Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ligji; nga ky akt themelimi dhe statut; dhe sa herë kjo kërkohet nga interesat e shoqërisë. Asambleja mbidhet cdo muaj.

15.2. Asambleja e përgjithshme mblidhet nga administratori ose nga ortaku i shoqërisë.

## **Neni 16 – Procedurat e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.**

16.1. Asambleja e shoqërisë mblidhet me njoftimm me shkrim ose në formë elektronike. Njoftimi përmban ditën dhe orë; rendin e ditës dhe dokumentacionin përkatës, dhe i njoftohet të gjithë ortakëve 7 ditë para datës së mbledhjes.

16.2. Kur asableja mblidhet pa respektuar afatin e parashikuar më sipër, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm me votë unanime dhe me pjesëmarrjen e gjithë ortakëve.

## **Neni 17 – Kërkesat e ortakëve në minorancë.**

17.1 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave në asamblenë e përgjithshme, mund të kërkojnë nga administratorët me shkrim të mbledhin asamblenë e shoqërisë ose të fusin në rend dite të mbledhjeve cështje specifike.

17.2 Kërkesa duhet të ketë arsyetimin, dhe cështjet për të cilat asambleja duhet të marrë vendim. Nëse kërkesa refuzohet, ortakët kanë të drejtë të kërkojnë që asambleja të mbidhet me rend dite vetëm cështjet që ata kanë kërkuar.

## **Neni 18 – Përfaqësimi në asamble**

18.1. Cdo oratak mund të përfaqësohet me akt nga një person tjetër.

18.2. Administratorët nuk mund të përfaqësojnë ortakët në mbledhje.

18.3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, ose edhe për mbledhjet vijuese për cështjet e rendit të ditës që nuk janë shqyrtuar dhe marrë vendim.

#### **Neni 19 – Kuorumi**

19.1 Nëse shoqëria do të marrë vendime që kërkojnë një shumicë të thjeshtë, mbledhja konsiderohet e vlefshme nëse janë prezent ortakë që zotërojnë më shumë se 30 % e kapitalit të shoqërisë.

19.2. Nëse shoqëria nuk merr vendime sipas pikës më sipër, ajo mblidhet brenda 30 ditëve me të njëtin rend dite.

19.3 Nëse shoqëria duhet të marrë vendime që kërkojnë shumicë të cilësuar, atëherë mbledhja mbahet nëse janë prezent oratkët që përfaqësojnë më shumë se 50% e kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 20**

20.1 Asambleja e përgjithshme merr vendim me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve prezent në mbledhje për ndryshimin e statutit; zmadhim ose zvogëlim të kapitalit të shoqërisë; ndarjen e fitimit; riorganizimin ose shpërndarjen e shoqërisë.

20.2 Asambleja e përgjithshme merr vendim me shumicë të thjeshtë për cështjet e tjera që pika më sipër ose ligji nuk kërkojnë një shumicë të cilësuar.

#### **Neni 21 – E drejta e votës**

21.1. Cdo kuotë ka të drejtën e një vote.

21.2. Ortakët, në përputhje me vullnetin tyre mund të marrin vendime unanime nëse kjo nuk ndalohet nga statuti ose nga ligji.

#### **Neni 22 – Përjashtimi nga e drejta e votës**

22.1 një nga ortakët nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme vendos: a) të vlerësojë aktivitetin e tij; b) anullimin e cdo detyrimi të tij; c) procedurë denoncimi për të; ç) lejimi ose jo të shërbimeve të tjera.

22.2 Nëse ortaku që përfaqësohet me autorizim është në konflikt interes, atëherë edhe përfaqësuesi është në të njëtin konflikt interes.

#### **Neni 23 – Proces verbali i mbledhjes.**

23.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme mbahen në proces verbal.

23.2 Proses verbali ka të dhëna si, vendi i mbajtjes së mbledhjes, data dhe ora, rendi i ditës, drejtuesi i mbledhjes, rezultatet e votimit, etj.

23.3 Proses verbali i bashkëlidhen lista e personave prezent në mbledhje, dhe njoftimi i mbledhjes.

23.4. Proses verbali firmoset nga drejuesi dhe nga personi që mban proces verbalin.

## **Neni 24 – Hetimet e vecanta**

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të nisë një hetim të vecantë për parregullsi në veprimet e themelimit të shoqërisë ose në ushtrimin e aktivitetit tregtar në përputhje me nenin 91 të Ligjit nr. 9901, del 14/04/2008 me gjithë ndryshimet.

## **Neni 25 – Revokimi i vendimeve të parregullta dhe zhdëmtimi.**

Asambleja e përgjithshme ka të drejtë të kërkojë para gjykatës kompetente anullimin e vendimeve të administratorëve kur ato janë marrë në shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, në përputhje me nenin 92 të ligjit nr.9901/2008 me gjithë ndryshimet.

## **Neni 26 – Administrimi.**

26.1. Shoqëria administrohet nga një administratorë. Asambleja e përgjithshme emëron administratorin për një periudhë kohe 5 vjecare me të drejtë riemërimi.

26.2. Administratori ka të drejta dhe detyrime:

- a) të kryejë administrimin e shoqërisë në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Generale;
- b) të përfaqësojë shoqërinë;
- c) të marrë masat e nevojshme për mbajtjen e saktë dhe në përputhje me ligjin të dokumentacionit finansiar dhe dokumentave të tjera të shoqërisë;
- ç) të pregatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor dhe raportet e aktivitetit së bashku me propozimin për ndarjen e fitimit, dhe të paraqesë në Asamblenë e Përgjithshme dokumentat përmiratim;
- d) të ndërtojë një sistem për lajmërimin në kohë për cështje dhe rrethana që rrezikojnë aktivitetin dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) ndjek dhe depoziton cdo vendim në QKR;
- e) informon dhe raporton para Asamblesë së Përgjithshme mbi situatën e politikave tregtare dhe cështjeve specifike të rëndësisë së vecantë për aktivitetin e shoqërisë;
- ë) ushtron të gjitha të drejtat e tjera që ja jep statuti dhe ligji.

26.3. Asambleja e Përgjithshme mund të lirojë nga detyra kurdoherë administratorin me shumicë të thjeshtë.

26.4. Administrator emërohet Xhoni Gjika, shtetas shqiptar, i datelindjes 23/05/1998, lindur ne Berat, Shqiperi.Banues ne adreesen Rruga 30 Vjetori, Berat.Shqiperi Nr. J80523050V.

## **Neni 27 – Detyrimi për besmikëri dhe përgjegjësi**

Administratori/ët është i detyruar që në ushtrimin e fuksioneve parashikuara nga ligji dhe statuti të veprojnë me mirëbesim, në interesin më të mirë të shoqërisë në përgjithësi.

Administratori/ët janë përgjegjës ndaj shoqërisë për cdo veprim që është kundër detyrave të tyre dhe kundër standardeve profesionale.

## **KAPITULLI IV**

### **Ndarja e fitimit**

### **Neni 28 – Ndarja e të mirave.**

Ortakët ka të drejtë të ndajnë fitimin i rezultuar nga bilanci i shoqërisë. Fitimi ndahet sipas pjesëmarrjes në shoqëri.

## **KAPITULLI V** **SHPËRNDARJA E SHOQËRISË**

### **Neni 29 – rastet e shpërndarjes së shoqërisë.**

Shoqëria shpërndahet:

- A. Kur i mbaron afati i parashikuar;
- B. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- C. Sipas procedurës të falimentit;
- D. sipas procedurës përkatëse nëse nuk ka aktivitet tregtar për dy vjet;
- E. Me vendim gjykate;

### **Neni 30 – Largimi i ortakut për motive të arsyeshme.**

një ortak mund të largohet ose përjashtohet nga shoqëria në kushtet dhe sipas procedurave të parashikuara në Ligjin nr. 9901, del 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me gjithë ndryshimet.

### **Neni 31 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 31.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në intepretim dhe aplikim të këtij statuti dhe akt themelimi (jo mosmarrëveshje jashtë shoqërisë që nuk kanë lidhje me shoqërinë), do të zgjidhen me mirëkuptim dhe do të diskutohen ndërmjet ortakëve që kanë mosmarrëveshje.
- 31.2. Në rast se nuk arrihet një marrëveshje për zgjidhje, atëherë mosmarrëveshja zgjidhet në gjykatën e shkallës së parë Tiranë.

Ky statut dhe akt themelimi hartohet dhe nënshkruhet në 4 kopje në gjuhën shqipe dhe italiane.

### **Themeluesit**

#### **ARTA SAKOLLI**

*Arta Sakolli*  
